



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRIA
MINISTËR SHTETI PËR PUSHTETIN VENDOR
AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E VETËQEVERISJES VENDORE**

PROCESVERBALI I MBLEDHJES

**TAKIMI I GRUPIT TEKNIK TË PUNËS SË PERFORMANCËS LIDHUR ME
TREGUESIT E PERFORMANCËS 2024 NË FUSHËN E MIRËQEVERISJES**

Tiranë, 8 Prill 2025

Hapja e mbledhjes

Në kuadër të përmirësimit të treguesve të performancës së Njësive të Vetëqeverisjes Vendore për vitin 2024, u mbajt mbledhja e dytë më 08.04.2025 në zyrat e Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore.

Z. *Stiljan Llavdaniti, Drejtor i Përgjithshëm i Komanduar, AMVV*, mbajti fjalën hapëse duke përshëndetur dhe falenderuar pjesëmarrësit.

Çështje të diskutuara

Znj. *Olta Caca, Drejtor i Drejtorisë së Statistikës dhe Performancës, AMVV* vijoi me prezantimin e gjetjeve të cilët kanë qenë pjesë e raportit të performancës, SMP 2023. U theksua qëllimi i takimit për konsultimin e treguesve ekzistues, të ndryshuar, apo të rinj për t'u shtuar, si dhe hartimin e propozimit final për treguesit e Sistemit të Matjes së Performancës 2024.

Gjetje nga raporti SMP 2023:

- U theksua fakti që të dhënat janë vetëraportime nga bashkitë;
- 91% e bashkive publikojnë online vendimet e tyre: një tregues me vlerë të lartë;
- 88% e projektakteve janë konsultuar me publikun;
- Është përdorur verifikim përmes burimeve administrative dhe faqeve online;
- Bashkitë e mëdha kanë sisteme të standardizuara për transparencë dhe konsultim online.

Komente:

Gjatë diskutimit mbi indikatorët e transparencës dhe publikimin e projektakteve, znj. *Adelina Farrici, Drejtor Ekzekutiv, SHKBSH* ngriti çështjen se për cilat akte bëhet fjalë për publikim.

Znj. *Caca* dhe z. *Llavdaniti* sqaruan se relacioni dhe drafti janë hapa paraprakë, ndërsa akti përfaqëson vendimmarrjen, e shoqëruar me minuta, procesverbalë apo relacion shpjegues. Z. *Llavdaniti* propozoi të zëvendësohet termi “projektligj” me “**projektvendim**” në treguesin përkatës.

Znj. *Ornela Shapo, Ekspert pranë BtF* sugjeroi ndarjen e indikatorit për konsultimet publike në dy pjesë për shkak të vështirësisë në parashikimin e akteve gjatë vitit dhe paqartësive mbi frazën e regjistrit elektronik. Z. *Llavdaniti* dhe Z. *Fatlum Nurja, Ekspert Projekti, Bashki të Forta* sqaruan se ligji kërkon tre regjistra (akte, vendime, konsultime) dhe u theksua se bëhet fjalë për Këshillin Bashkiak dhe se aktet e keshillit janë vendimet. Procesverbalë është pjesë shoqëruese e aktit. Projektvendimi hartohet nga struktura juridike e NJVV.

Znj. *Shapo* vijoi duke u shprehur se treguesi përsëri nuk është i matshëm, pasi duhet të ketë një numërues dhe një emërues. Sipas saj duhet shprehur: Numri gjithsej i vendimeve të ngarkuara /Numri gjithsej i vendimeve.

Znj. *Emerlinda Pema, Drejtor DMPT, KDIMDP* vlerësoi ruajtjen e treguesit në fjalë dhe theksoi se ai bazohet në punën shumëvjeçare të Zyrës së Komisionerit e cila, sipas Ligjit Nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, harton programin e transparencës. Ky program është miratuar me urdhër të posaçëm dhe përmban elementë të detajuar, si kalendari i mbledhjeve të keshillit, njoftimet, rendi i ditës, projektvendimet, procesverbalët dhe vendimet, të cilat

monitorohen çdo vit nga KDIMDP. Ajo theksoi se nuk është e nevojshme të krijohen tregues të rinj, por të agregohen ata ekzistues dhe të matet zbatueshmëria. Për këtë qëllim, hartohet çdo vit një indeks transparence për qeverisjen qendrore dhe vendore, duke krahasuar rezultatet me vitet e mëparshme. Ajo sqaroi se kapacitetet e kufizuara të Komisionerit ndikojnë në numrin e treguesve të përfshirë dhe se këshillat bashkiakë monitorohen në kuadër të qeverisjes vendore, ndryshe nga njësitë e vetëqeverisjes vendore. *Znj. Pema* sqaroi se bëhet fjalë për qarqet e ndryshme dhe theksoi se duke u kthyer te treguesit e shkallës së publikimit, mund të vlerësohen duke përdorur **indeksin e tyre**. Ajo shpjegoi se indeksi reflekton publikimin e akteve në fund të çdo viti, duke ofruar një “fotografi” të procesit të transparencës. Për këtë indikator, ajo njoftoi se 13 bashki janë vlerësuar me një transparencë proaktive të ulët, për vitin 2024.

Z. Llavdaniti njoftoi se përpara grumbullimit të të dhënave të performancës do të zhvillohen trajnime paraprake dhe do të prezantohet korniza që duhet të ndjekin aktet për të kaluar në një proces të gjerë konsultimi publik.

Nga ana e saj, *Znj. Voltana Ademi, Eksperte, Smart Processes*, u shpreh se vështirësia qëndron në verifikimin e raportimeve, pasi këshillat nuk i referohen dispozitës së duhur, duke shmangur konsultimin publik edhe në rastet kur ai është i detyrueshëm. Ajo shtoi se pyetjet kryesore që shqyrton AMVV lidhen me faktin nëse indikatorët janë të rëndësishëm, të matshëm, të domosdoshëm dhe nëse duhen përfshirë në Sistemin e Matjes së Performancës.

Znj. Caca vijoi prezantimin duke listuar treguesin i cili është sugjeruar të mbahet i pandryshuar:

1. Shkalla e publikimit online të vendimeve të bashkisë

Treguesi i cili u sugjerua të ndahet ishte “Shkalla e projektakteve për të cilat është bërë konsultim publik”, si më poshtë:

- 1. Ngarkimi i vendimeve të projektvendimeve të këshillit në regjistrin elektronik të bashkisë në faqen zyrtare të internetit;**
- 2. Publikimi i Akteve të Mbledhjeve të Këshillit të Bashkisë në faqen zyrtare të internetit.**

Si dhe treguesit e sugjeruar të shtohen:

- 1. Transmetimi në kohë reale i mbledhjeve të Këshillit të Bashkisë**
- 2. Plani i Integritetit, i cili është një tregues i Grantit të Bazuar në Performancë.**

Znj. Caca e vijoi diskutimin lidhur me këto sugjerime duke sqaruar se janë shqyrtuar faqet zyrtare të bashkive dhe sistemet elektronike për dokumentacionin verifikues, dhe se analiza e mëparshme ka sjellë mundësi të qarta për përmirësim.

Znj. Pema theksoi se baza ligjore për transparencën është në fuqi që nga viti 2014 dhe nuk është e nevojshme të shtohen indikatorë të rinj, pasi ata **janë të përcaktuar në programin ekzistues**. Monitorimi duhet të bëhet mbi këtë program, pasi është **një detyrim ligjor**. Ajo shtoi se programi do të pësojë ndryshime këtë vit pas rishikimit pesëvjeçar. Po ashtu, përdorimi i sistemit “semafor” për vitin 2024, ka treguar se nuk ka pasur bashki në ngjyrë të kuqe, por ka

pasur një rënie të bashkive në ngjyrë jeshile. *Znj Pema* u shpreh se do të ndajë këtë raport¹ me AMVV i cili është finalizuar në shkurt të këtij viti.

Z. Nurja propozoi që një nga indikatorët të jetë publikimi i raportit mbi procesin e konsultimit të aktit.

Znj. Pema theksoi se një nga indikatorët e programit aktual është ekzistenca e një plani vjetor. Komisioneri ka përgjegjësi vetëm për shqyrtimin e ankesave lidhur me ligjin për njoftimin dhe konsultimin publik, dhe jo për zbatimin e tij. Ajo sqaroi se programi i transparencës përfshin edhe detyrime të tjera ligjore dhe është mbështetur në referenca të qarta ligjore. Sipas saj, një kërkesë kryesore është hartimi i planit vjetor, që mund të shërbejë si indikator, dhe pas tij përgatitja e një raporti përmbyllës në fund të vitit.

Znj. Silvana Rusi, Këshilltar, MAPA, sugjeroi që mund të merreshin shembuj të mirë nga Kryeministria për indikatorët dhe raportimet në Komisionin Evropian.

Znj. Shapo theksoi se nuk mjafton vetëm hedhja e dokumenteve, por duhet të mbahen tryeza dhe të publikohen minuta dhe procesverbale për transparencë. Ajo theksoi rëndësinë e dokumenteve për konsultim dhe dëshirën e qytetarëve për të ditur detaje mbi procesin.

Znj. Rusi shtoi nevojën për përmirësimin e standardeve të punonjësve të administratës për të arritur rezultate më të mira. Gjithashtu përmendi rëndësinë e raporteve të konsultimit publik dhe transparencës së arsytimit për pranimin ose refuzimin e komenteve.

Përfundime

Anëtarët e grupit teknik të punës ranë dakord që do të **përdoren** treguesit ligjor nga programi i transparencës për ushtrimin e SMP 2024, duke shqyrtuar këto dokumenta:

1. [Indeksin të Transparencës Proaktive të NJVV](#);
2. [Listën e treguesve nga Programi Model i Transparencës për NJVV](#);

dhe mbi bazën e këtyre treguesve do të vendoset për **5 treguesit përfundimtarë** në fushën e Mirëqeverisjes për SMP 2024, nga të cilët:

- **1 tregues i përket GBP, ekzistenca e Planit Vendor të Integritetit;**
- **2 tregues** do të merren nga vlerësimi që ka realizuar Komisioneri për NJVV gjatë 2024;
- **2 tregues** të tjerë do të vlerësohen nga Programi Model i Transparencës që nuk janë monitoruar nga Komisioneri për 2024.

¹ [Indeksi-i-Transparences-proaktive-te-njesive-te-veteqeverisjes-vendore-viti-2024.pdf](#)